4. Për qëllime të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, fitimet që rrjedhin nga një rezident i një juridiksioni kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose interesave të krahasueshme, si interesa në një partneritet ose trust, mund të taten në juridiksionin tjetër kontraktues nëse, në çdo kohë gjatë 365 ditë para tjetërsimit, këto aksione ose interesa të krahasueshme realizojnë më shumë se 50 për qind e vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jo nga prona e paluajtshme që ndodhet në atë juridiksion tjetër kontraktues.

5. Paragrafi 4 do të zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, me kusht që fitimet që rrjedhin nga një rezident i një juridiksioni kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose të drejtave të tjera të pjesëmarrjes në një subjekt mund të taten në juridiksionin tjetër kontraktues, me kusht që më shumë se një pjesë e caktuar e vlerës së këtyre aksioneve apo të drejtave të vijnë nga pasuria e paluajtshme që ndodhet në atë juridiksion tjetër kontraktues, ose me kusht që më shumë se një pjesë e caktuar e pasurisë së subjektit të përbëhet nga kjo pasuri e paluajtshme.

6. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë paragrafin 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;

b) të mos zbatojë nënparagrafin “a”, të paragrafit 1, në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;

c) të mos zbatojë nënparagrafin “b”, të paragrafit 1, në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;

d) të mos zbatojë nënparagrafin “a”, të paragrafit 1, në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 1 që përfshin një periudhë për të përcaktuar nëse është arritur pragu i vlerës përkatëse;

e) të mos zbatojë nënparagrafin “b”, të paragrafit 1, në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 1 që përfshin një

dispozitë të përshkruar në paragrafin 1 që zbatohet për tjetërsimin e interesave të ndryshëm nga aksionet;

f) të mos zbatojë paragrafin 4 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë dispozitat e përshkruara në paragrafin 5.

7. Secila palë që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 6, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 1 dhe nëse po, nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Paragrafi 1 do të zbatohet në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim në lidhje me atë dispozitë.

8. Secila Palë që zgjedh të zbatojë paragrafin 4 do të njoftojë Depozituesin për zgjedhjen e saj. Paragrafi 4 zbatohet për një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë. Në këtë rast, paragrafi 1 nuk do të zbatohet në lidhje me atë marrëveshje për tatimet e mbuluara. Në rastin e një Pale që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “P”, të paragrafit 6, dhe ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 6, ky njoftim duhet të përfshijë edhe listën e marrëveshjeve për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 5, si dhe nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim lidhur me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara sipas këtij paragrafi ose paragrafit 7, kjo dispozitë zëvendësohet me dispozitat e paragrafit 4. Në raste të tjera, paragrafi 4 do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në masën që këto dispozita nuk janë në përputhje me paragrafin 4.

## Neni 10

### **Rregullat kundër abuzimit për selitë e përhershme të vendosura në juridiksione të treta**

#### 1. Ku:

a) një ndërmarrje e një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara realizon të ardhura nga juridiksioni tjetër kontraktues dhe juridiksioni kontraktues i parë i përmendur trajton të ardhura të tilla që i atribuohen një selie të përhershme të ndërmarrjes që ndodhet në një juridiksion të tretë; dhe

b) fitimet që i atribuohen asaj selie të përhershme janë të përjashtuara nga tatimi në kompetencën e juridiksionit të parë kontraktues të lartpërmendur,

përfitimet nga marrëveshja për tatimet e mbuluara nuk do të zbatohen për asnjë zë të të ardhurave mbi të cilat tatimi në juridiksionin e tretë është më pak se 60 për qind e tatimit që do të vendosej në juridiksionin e parë kontraktues të përmendur për atë zë të ardhurash nëse kjo seli e përhershme do të ndodhej në juridiksionin e parë kontraktues. Në një rast të tillë, të gjitha të ardhurat për të cilat zbatohen dispozitat e këtij paragrafi mbeten të tatueshme sipas ligjit vendas të juridiksionit tjetër kontraktues, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e marrëveshjes për tatimet e mbuluara.

2. Paragrafi 1 nuk do të zbatohet nëse të ardhurat e përfituara nga juridiksioni tjetër kontraktues të përshkruara në paragrafin 1 rrjedhin në lidhje me ose janë të rastësishme për zhvillimin aktiv të një biznesi të kryer përmes selisë së përhershme (përveç biznesit të realizimit, administrimit ose thjesht të mbajtjes së investimeve për llogarinë e ndërmarrjes, me përjashtim të rasteve kur këto aktivitete janë veprimtari bankare, sigurimi ose letrash me vlerë të kryera nga një bankë, ndërmarrje sigurimesh ose ndërmjetës i regjistruar për letrat me vlerë).

3. Nëse përfitimet nga një marrëveshje për tatimet e mbuluara mohohen sipas paragrafit 1 në lidhje me një zë të ardhurash që rrjedhin nga një rezident i një juridiksioni kontraktues, autoriteti kompetent i juridiksionit tjetër kontraktues, megjithatë, mund t'i japë këto përfitime në lidhje me atë zë të ardhurash nëse, në përgjigje të një kërkesë nga një rezident i tillë, ai autoritet kompetent konstaton se dhënia e këtyre përfitimeve është e justifikuar për shkak të arsyeve që ai rezident

nuk i ka përmbushur kërkesat e paragrafëve 1 dhe 2. Autoriteti kompetent i juridiksionit kontraktues, drejt të cilit është bërë një kërkesë në bazë të fjalisë së mëparshme nga një rezident i juridiksionit tjetër kontraktues do të konsultohet me autoritetin kompetent të atij juridiksioni kontraktues përpara se të pranojë ose mohojë kërkesën.

4. Paragrafët 1 deri në 3 do të zbatohen në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që mohojnë ose kufizojnë përfitimet që ndryshe do t'i jepeshin një ndërmarrjeje të një juridiksioni kontraktues që realizon të ardhura nga Juridiksioni tjetër Kontraktues që i atribuohet një selie të përhershme të ndërmarrjes që ndodhet në një juridiksion të tretë.

5. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

- a) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;
- b) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë dispozitat e përshkruara në paragrafin 4;
- c) të zbatojë këtë nen vetëm në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë dispozitat e përshkruara në paragrafin 4.

6. Secila Palë që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin "a" ose "b", të paragrafit 5, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila prej marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 4 dhe nëse po, nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozite të tillë. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, ajo dispozitë do të zëvendësohet me dispozitat e paragrafëve nga 1 deri në 3. Në raste të tjera, paragrafët nga 1 deri në 3 do të zëvendësojnë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në masën që këto dispozita nuk janë në përputhje me ato paragrafë.

#### Neni 11

### **Zbatimi i marrëveshjeve tatimore për të kufizuar të drejtën e një pale për të tatuar rezidentët e saj**

1. Marrëveshja për tatimet e mbuluara nuk do të ndikojë në tatimin e një juridiksioni kontraktues të rezidentëve të tij, përveç në lidhje me përfitimet e dhëna sipas dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara:

a) të cilat kërkojnë që juridiksioni kontraktues t'i bëjë një ndërmarrjeje të atij juridiksioni kontraktues një rregullim të lidhur ose korrespondues pas një rregullimi fillestar të bërë nga juridiksioni tjetër kontraktues, në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara, në shumën e tatimit të vendosur në juridiksionin e parë kontraktues të përmenduri mbi fitimet e një selie të përhershme të ndërmarrjes ose fitimet e një ndërmarrjeje të lidhur me të;

b) të cilat mund të ndikojnë në mënyrën sesi ai juridiksion kontraktues taton një individ, i cili është rezident i atij juridiksioni kontraktues nëse ai individ realizon të ardhura në lidhje me shërbimet e kryera për juridiksionin tjetër kontraktues ose nënndarje politike ose autoritet lokal ose organ tjetër i krahasueshëm i tij;

c) të cilat mund të ndikojnë në mënyrën sesi ai juridiksion kontraktues taton një individ, i cili është rezident i atij juridiksioni kontraktues nëse ai individ është gjithashtu student, biznesmen në fillimet e tij ose i trajnuar, ose mësues, profesor, lektor, instruktor, studiues ose studiues hulumtues i cili plotëson kushtet e marrëveshjes për tatimet e mbuluara;

d) të cilat kërkojnë që juridiksioni kontraktues të ofrojë një kreditim tatimor ose përjashtim tatimor për rezidentët e atij juridiksioni kontraktues në lidhje me të ardhurat që juridiksioni tjetër kontraktues mund të tatojë në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara (duke përfshirë fitimet që i atribuohen një selie të përhershme të vendosur në atë juridiksion tjetër kontraktues në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara);

e) që mbrojnë rezidentët e atij juridiksioni kontraktues kundër praktikave të caktuara tatimore diskriminuese nga ai juridiksion kontraktues;

f) të cilat lejojnë rezidentët e atij juridiksioni kontraktues që të kërkojnë që autoriteti kompetent i atij ose cilitdo juridiksioni kontraktues të marrë në konsideratë rastet e tatimit që nuk janë në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara;

g) të cilat mund të ndikojnë në mënyrën sesi ai juridiksion kontraktues taton një individ që është rezident i atij juridiksioni kontraktues nëse ai individ është anëtar i një misioni diplomatik, misioni qeveritar ose posti konsullor i atij juridiksioni tjetër kontraktues;

h) të cilat parashikojnë që pensionet ose pagesat e tjera të kryera sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore të juridiksionit tjetër kontraktues do të taten vetëm në atë juridiksion tjetër kontraktues;

i) të cilat parashikojnë që pensionet dhe pagesat e ngjashme, pensionet e tjera, pagesat e ushqimeve ose pagesat e tjera të jetesës që lindin në juridiksionin tjetër kontraktues do të taten vetëm në atë juridiksion tjetër kontraktues; ose

j) të cilat ndryshe kufizojnë shprehimisht të drejtën e juridiksionit kontraktues për të tatuar rezidentët e vet ose që parashikojnë shprehimisht se juridiksioni kontraktues në të cilin lind një element i të ardhurave ka të drejtën ekskluzive për të tatuar atë element të ardhurash.

2. Paragrafi 1 do të zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara ku përcaktohet se marrëveshja për tatimet e mbuluara nuk do të ndikonte në tatimin e një juridiksioni kontraktues të rezidentëve të tij.

3. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;

b) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë dispozitat e përshkruara në paragrafin 2.

4. Secila Palë që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “a” ose “b”, të paragrafit 3, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 2 dhe nëse po, numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozite të tillë. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë do të zëvendësohet me dispozitat e paragrafit 1. Në raste të tjera, paragrafi 1 zëvendëson dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në masën që këto dispozita nuk janë në përputhje me paragrafin 1.

#### PJESA IV

#### SHMANGIA E STATUSIT TË SELISË SË PËRHERSHME

##### Neni 12

#### **Shmangia artificiale e statusit të selisë së përherëshme nëpërmjet marrëveshjeve të komisionerëve dhe strategjive të ngjashme**

1. Pavarësisht nga dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përcakton termin “seli e përherëshme”, por subjekt i paragrafit 2, ku një person vepron në një juridiksion kontraktues në bazë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara në emër të një ndërmarrjeje dhe, duke vepruar në këtë mënyrë, zakonisht lidh kontrata, ose zakonisht luan rolin kryesor që çon në lidhjen e kontratave që zakonisht lidhen pa ndryshime materiale nga ndërmarrja dhe këto kontrata janë:

a) në emër të ndërmarrjes; ose

b) për transferimin e pronësisë ose për dhënien e së drejtës së përdorimit të pronave në pronësi të kësaj ndërmarrjeje ose të cilat ndërmarrja ka të drejtë t'i përdorë; ose

c) për ofrimin e shërbimeve nga ajo ndërmarrje,

ajo ndërmarrje konsiderohet të ketë një seli të përherëshme në atë juridiksion kontraktues në lidhje me çdo veprimtari që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, me përjashtim të rasteve kur këto veprimtari, nëse janë ushtruar nga ndërmarrja nëpërmjet një vendi fiks të biznesit të asaj

ndërmarrjeje që ndodhet në atë juridiksion kontraktues, nuk do të përcaktonin që ai vend fiks biznesi të konsiderohet si një seli e përhershme në bazë të përkufizimit të selisë së përhershme të përfshirë në marrëveshjen për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga kjo Konventë).

2. Paragrafi 1 nuk do zbatohet kur personi që vepron në një juridiksion kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara në emër të një ndërmarrjeje të juridiksionit tjetër kontraktues ushtron biznes në juridiksionin e parë kontraktues të lartpërmendur si agjent i pavarur dhe vepron për ndërmarrjen në kuadrin e aktiviteteve të zakonshme të atij biznesi. Megjithatë, kur një person vepron ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht në emër të një ose më shumë ndërmarrjeve me të cilat ka lidhje të ngushta, ai person nuk do të konsiderohet se është agjent i pavarur sipas kuptimit të këtij paragrafi në lidhje me çfarëdo ndërmarrje të tillë.

3. a) Paragrafi 1 do të zbatohet në vend të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përshkruajnë kushtet në të cilat një ndërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në një juridiksion kontraktues (ose një person do të konsiderohet të jetë një seli e përhershme në një juridiksion kontraktues) në lidhje me një aktivitet që një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, e kryen për ndërmarrjen, por vetëm në atë masë që dispozitat e tilla trajtojnë situatën në të cilën personi i tillë ka dhe ushtron zakonisht në atë juridiksion kontraktues një autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes.

b) Paragrafi 2 do të zbatohet në vend të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që parashikojnë se një ndërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në një juridiksion kontraktues në lidhje me një aktivitet që një me status të pavarur e kryen për ndërmarrjen.

4. Një Palë mund të rezervojë të drejtën që ky nen të mos zbatohet në tërësi në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara.

5. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në paragrafin 4 do të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 3, si dhe numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Paragrafi 1 do të zbatohet në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim në lidhje me atë dispozitë.

6. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në paragrafin 4 do të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 3, si dhe numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Paragrafi 2 do të zbatohet në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë dispozitë.

### Neni 13

#### **Shmangia artificiale e statusit të selisë së përhershme nëpërmjet përjashtimeve të veprimtarive specifike**

1. Një Palë mund të zgjedhë të zbatojë paragrafin 2 (Opsioni A) ose paragrafin 3 (Opsioni B) ose të mos zbatojë asnjë Opsion.

##### **Opsioni A**

2. Pavarësisht nga dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përcaktojnë termin “seli e përhershme”, termi “seli e përhershme” do të konsiderohet se nuk përfshin:

a) aktivitetet e renditura në mënyrë specifike në marrëveshjen për tatimet e mbuluara (para ndryshimit nga kjo Konventë), si aktivitete që konsiderohen se nuk përbëjnë një seli të përhershme, pavarësisht nëse përjashtimi nga statusi i selisë së përhershme varet nga karakteri përgatitor ose ndihmës i aktivitetit;

b) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllimin e kryerjes për ndërmarrjen, të çdo lloji aktiviteti që nuk është përshkruar në nënparagrafin “a”;

c) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çfarëdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” dhe “b”,

me kusht që një veprimtari e tillë ose, në rastin e nënparagrafit “c”, veprimtaria e përgjithshme e vendit fiks të biznesit, të ketë karakter përgatitor ose ndihmës.

### **Opsioni B**

3. Pavarësisht nga dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përcaktojnë termin “seli e përherëshme”, termi “seli e përherëshme” do të konsiderohet se nuk përfshin:

a) aktivitetet e renditura në mënyrë specifike në marrëveshjen për tatimet e mbuluara (para ndryshimit nga kjo Konventë), si aktivitete që konsiderohen se nuk përbëjnë një seli të përherëshme, pavarësisht nëse përjashtimi nga statusi i selisë së përherëshme varet nga karakteri përgatitor ose ndihmës i aktivitetit, përveç situatës në të cilën dispozita përkatëse e marrëveshjes për tatimet e mbuluara përcakton shprehimisht që një aktivitet specifik do të konsiderohet se nuk përbën një seli të përherëshme, me kusht që aktiviteti të ketë një karakter përgatitor ose ndihmës;

b) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllimin e kryerjes për ndërmarrjen, të çdo lloji aktiviteti që nuk është përshkruar në nënparagrafin “a”, me kusht që ky aktivitet të ketë karakter përgatitor ose ndihmës;

c) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çfarëdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” dhe “b”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

4. Një dispozitë e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga paragrafi 2 ose 3) që rendit aktivitetet specifike që konsiderohen se nuk përbëjnë një seli të përherëshme nuk do të zbatohet në një vend fiks biznesi që përdoret ose mirëmbahet nga një ndërmarrje nëse e njëjta ndërmarrje ose një ndërmarrje me të cilën ka lidhje të ngushtë kryen aktivitete biznesi në të njëjtin vend ose në një vend tjetër në të njëjtin juridiksion kontraktues dhe:

a) ai vend ose një vend tjetër përbën një seli të përherëshme për ndërmarrjen ose ndërmarrjen me të cilën ka lidhje të ngushtë sipas dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përcakton një seli të përherëshme; ose

b) aktiviteti i përgjithshëm që rezulton nga kombinimi i veprimtarive të kryera nga të dyja ndërmarrjet në të njëjtin vend, ose nga e njëjta ndërmarrje ose ndërmarrjet që kanë lidhje të ngushtë në të dyja vendet, nuk ka karakter përgatitor ose ndihmës,

me kusht që aktivitetet e biznesit të kryera nga dy ndërmarrjet në të njëjtin vend ose nga e njëjta ndërmarrje ose ndërmarrjet e lidhura ngushtë në të dyja vendet, të përfaqësojnë funksione plotësuese që janë pjesë e një operacioni koheziv biznesi.

5. a) Paragrafët 2 ose 3 do të zbatohen në vend të pjesëve përkatëse të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që rendisin aktivitete specifike të cilat konsiderohen se nuk përbëjnë një seli të përherëshme, edhe nëse aktiviteti kryhet nëpërmjet një vendi fiks biznesi (ose dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që vepron në mënyrë të ngjashme).

b) Paragrafi 4 do të zbatohet për dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga paragrafët 2 ose 3) që rendisin aktivitete specifike të cilat konsiderohen se nuk përbëjnë një seli të përherëshme edhe nëse aktiviteti kryhet nëpërmjet një vendi fiks biznesi (ose dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që veprojnë në mënyrë të ngjashme).

6. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;

b) të mos zbatojë paragrafin 2 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që përcaktojnë shprehimisht se një listë e aktiviteteve specifike do të konsiderohet se nuk përbëjnë një seli të përherëshme vetëm nëse secili prej aktiviteteve është i një karakteri përgatitor ose ndihmës;

c) të mos zbatojë paragrafin 4 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara.

7. Secila palë që zgjedh të zbatojë një Opsion sipas paragrafit 1 duhet të njoftojë Depozituesin për zgjedhjen e Opsionit. Njoftimi i tillë përfshin gjithashtu listën e marrëveshjeve për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë të përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 5, si dhe numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Një Opsion do të zbatohet në lidhje me

një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë zgjedhur të zbatojnë të njëjtin Opsion dhe kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë dispozitë.

8. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në nënparagrafin “a” ose “c”, të paragrafit 6, dhe nuk zgjedh të zbatojë një Opsion sipas paragrafit 1, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 5, si dhe numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Paragrafi 4 do të zbatohet në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim në lidhje me atë dispozitë sipas këtij paragrafi ose paragrafit 7.

#### Neni 14

### **Ndarja e kontratave**

1. Për qëllimin e vetëm të përcaktimit nëse është tejkalar periudha (ose periudhat) e përmendura në një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përcakton një periudhë (ose periudha) të kohës pas së cilës projekte ose aktivitete specifike do të përbëjnë një seli të përhershme:

a) kur një ndërmarrje e një juridiksioni kontraktues kryen veprimtari në juridiksionin tjetër kontraktues në një vend që përbën një kantier ndërtimi, projekt ndërtimi, projekti instalimi ose projekt tjetër specifik të identifikuar në dispozitën përkatëse të marrëveshjes për tatimet e mbuluara, ose zhvillon aktivitete mbikëqyrjeje ose konsulence në lidhje me një vend të tillë, në rastin e një dispozite të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që i referohet këtyre aktiviteteve dhe këto aktivitete vazhdojnë gjatë një ose më shumë periudhave kohore që në tërësi kalojnë 30 ditë pa tejkalar periudhën ose periudhat e përmendura në dispozitën përkatëse të marrëveshjes për tatimet e mbuluara; dhe

b) kur aktivitetet e ndërlidhura kryhen në atë juridiksion tjetër kontraktues (ose kur dispozita përkatëse e marrëveshjes për tatimet e mbuluara zbatohet për aktivitete mbikëqyrjeje ose konsulence, në lidhje me to) në të njëjtin kantier ndërtimi, projekt ndërtimi ose instalimi, ose vend tjetër të identifikuar në dispozitën përkatëse të marrëveshjes për tatimet e mbuluara gjatë periudhave të ndryshme kohore, secila tejkalon 30 ditë, nga një ose më shumë ndërmarrje të lidhura ngushtë me ndërmarrjen e parë të lartpërmendur,

këto periudha të ndryshme kohore do të shtohen në periudhën e përgjithshme gjatë së cilës ndërmarrja e parë e lartpërmendur ka kryer aktivitetet në atë kantier ndërtimi, projekt ndërtimi ose instalimi, ose vend tjetër të identifikuar në dispozitën përkatëse të marrëveshjes për tatimet e mbuluara.

2. Paragrafi 1 do të zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara në masën që këto dispozita trajtojnë ndarjen e kontratave në pjesë të shumëfishta për të shmangur zbatimin e një periudhe kohore ose periudhash në lidhje me ekzistencën e një selie të përhershme për projekte ose aktivitete specifike të përshkruara në paragrafin 1.

3. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;

b) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në lidhje me dispozitat e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara në lidhje me kërkimin ose shfrytëzimin e burimeve natyrore.

4. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 3, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila prej marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 2 që nuk i nënshtrohet një rezerve sipas nënparagrafit “b”, të paragrafit 3, dhe nëse po, numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë do të zëvendësohet me

dispozitat e paragrafit 1 në masën e parashikuar në paragrafin 2. Në raste të tjera, paragrafi 1 do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në masën që këto dispozita nuk janë në përputhje me paragrafin 1.

#### Neni 15

### **Përkufizimi i një personi të lidhur ngushtë me një ndërmarrje**

1. Për qëllime të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që ndryshohen nga paragrafi 2, i nenit 12 (“Shmangia artificiale e statusit të selisë së përhershme nëpërmjet marrëveshjeve të komisionerëve dhe strategjive të ngjashme”), paragrafi 4, i nenit 13 (“Shmangia artificiale e statusit të selisë së përhershme nëpërmjet përjashtimeve të veprimtarive specifike”) ose paragrafi 1, i nenit 14 (“Ndarja e kontratave”), një person është i lidhur ngushtë me një ndërmarrje nëse, në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave përkatëse, njëri ka kontrollin e tjetrit ose të dy janë nën kontrollin e personave apo ndërmarrjeve të njëjta. Në çdo rast, një person do të konsiderohet se është i lidhur ngushtë me një ndërmarrje, nëse zotëron drejtpërdrejt ose jo më shumë se 50 për qind të interesit përfitues të tjetrit (ose në rastin e një shoqërie, më shumë se 50 për qind të votave të përgjithshme dhe vlerës totale të aksioneve të kompanisë ose të interesit të kapitalit përfitues në shoqëri) ose nëse një person zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më shumë se 50 për qind të interesit përfitues (ose, në rastin e një shoqërie, më shumë se 50 për qind të votave të përgjithshme dhe vlerës totale të aksioneve të shoqërisë ose të interesit të kapitalit përfitues në shoqëri) në person dhe ndërmarrje.

2. Një Palë që ka bërë rezervat e përshkruara në paragrafin 4, të nenit 12 (“Shmangia artificiale e statusit të selisë së përhershme nëpërmjet marrëveshjeve të komisionerëve dhe strategjive të ngjashme”), nënparagrafin “a” ose “c”, të paragrafit 6, të nenit 13 (“Shmangia artificiale e statusit të selisë së përhershme përmes përjashtimeve të veprimtarive specifike”) dhe nënparagrafin “a”, të paragrafit 3, të nenit 14 (“Ndarja e kontratave”) mund të rezervojnë të drejtën për të mos zbatuar në tërësi këtë nen në marrëveshjet për tatimet e mbuluara në të cilat zbatohen këto rezerva.

#### PJESA V

### **PËRMIRËSIMI I ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE**

#### Neni 16

### **Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë (zgjidhja me mirëkuptim)**

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy juridiksioneve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për atë person në tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, ai person, pavarësisht nga mjetet juridike të parashikuara nga ligji vendas i atyre juridiksioneve kontraktuese, mund të paraqesë çështjen tek autoriteti kompetent i cilitdo juridiksioni kontraktues. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara.

2. Autoriteti kompetent do të përpiqet, nëse kundërshtimi i duket i justifikuar dhe nëse vetë ai nuk mund të arrijë në një zgjidhje të pranueshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje të ndërsjellë (zgjidhje me mirëkuptim) me autoritetin kompetent të juridiksionit tjetër kontraktues, me qëllim që të shmangë tatimin që nuk është në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga çdo kufizim kohor në ligjin vendas të juridiksioneve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje të ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjes për tatimet e mbuluara. Ato, gjithashtu, mund të konsultohen së bashku

për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk parashikohen në marrëveshjen për tatimet e mbuluara.

4. a) i) Fjalja e parë e paragrafit 1 do të zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara (ose pjesëve të saj), që parashikojnë se kur një person konsideron se veprimet e njërit apo dy juridiksioneve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për atë person në tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, ai person, pa marrë parasysh mjetet juridike të parashikuara nga ligji vendas i këtyre juridiksioneve kontraktuese, mund t'ia paraqesë çështjen autoritetit kompetent të juridiksionit kontraktues në të cilin ai person është rezident, duke përfshirë dispozita sipas të cilave, në qoftë se çështja e paraqitur nga ai person është sipas dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara në lidhje me mosdiskriminimin bazuar në shtetësi, çështja mund të paraqitet pranë autoritetit kompetent të juridiksionit kontraktues në të cilin është shtetas ai person.

ii. Fjalja e dytë e paragrafit 1 do të zbatohet në vend të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që parashikojnë faktin se një çështje së cilës i referohet fjalia e parë e paragrafit 1 duhet të paraqitet brenda një periudhe të caktuar kohore që është më e shkurtër se tre vjet nga njoftimi i parë i veprimit nga i cili rezulton një tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, ose në mungesë të një dispozite të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përshkruan afatin kohor brenda të cilit duhet të paraqitet një çështje e tillë.

b) i. Fjalja e parë e paragrafit 2 do të zbatohet në mungesë të dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara, që parashikojnë se autoriteti kompetent të cilit i paraqitet çështja nga personi i referuar në paragrafin 1 do të përpiqet, nëse kundërshtimi i duket i justifikuar dhe nëse vetë nuk mund të arrijë në një zgjidhje të pranueshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje të ndërsjellë me autoritetin kompetent të juridiksionit tjetër kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara.

ii. Fjalja e dytë e paragrafit 2 do të zbatohet në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, duke siguruar që çdo marrëveshje e arritur të zbatohet pavarësisht nga çdo afat kohor në ligjin vendas të juridiksioneve kontraktuese.

c) i. Fjalja e parë e paragrafit 3 do të zbatohet në mungesë të dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara që parashikojnë se autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje të ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshime që lindin për interpretimin ose zbatimin e marrëveshjes për tatimet e mbuluara.

ii. Fjalja e dytë e paragrafit 3 do të zbatohet në mungesë të dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara që parashikojnë se autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk parashikohen në marrëveshjen për tatimet e mbuluara.

5. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë fjalinë e parë të paragrafit 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara në bazë të faktit që synon të përmbushë standardin minimal për përmirësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në kuadër të Paketës BEPS të OECD/G20, duke siguruar që në bazë të secilës nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara (përveç një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që lejon një person të paraqesë një rast pranë autoritetit kompetent të cilitdo juridiksion kontraktues), atëherë kur një person konsideron se veprimet e njërit ose të dy juridiksioneve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për atë person në tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, pavarësisht nga mjetet juridike të parashikuara nga ligji vendas i këtyre juridiksioneve kontraktuese, ai person mund t'ia paraqesë rastin autoritetit kompetent të juridiksionit kontraktues në të cilin personi është rezident ose nëse rasti i paraqitur nga ai person është sipas një dispozite të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara në lidhje me mosdiskriminimin bazuar në shtetësi, në juridiksionin kontraktues në të cilin ky person është shtetas; dhe autoriteti kompetent i atij juridiksioni kontraktues do të zbatojë një proces dypalësh njoftimi ose konsultimi me autoritetin kompetent të juridiksionit tjetër

kontraktues për rastet në të cilat autoriteti kompetent të cilit i është paraqitur çështja e procedurës së ndërsjellë nuk e konsideron kundërshtimin e tatimpaguesit si të justifikuar;

b) të mos zbatohet fjalinë e dytë të paragrafit 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që nuk parashikojnë se rasti i referuar në fjalinë e parë të paragrafit 1 duhet të paraqitet brenda një periudhe të caktuar kohore në bazë të faktit që synon të përmbushë standardin minimal për përmirësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në kuadër të Paketës BEPS të OECD/G20, duke siguruar që për qëllimet e të gjitha marrëveshjeve të tilla për tatimet e mbuluara, tatimpaguesi i referuar në paragrafin 1 lejohet ta paraqesë çështjen brenda një periudhe prej të paktën tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara;

c) të mos zbatohet fjalinë e dytë të paragrafit 2 në marrëveshjet për tatimet e mbuluara mbi bazën e faktit që, për qëllimet e të gjitha marrëveshjeve për tatimet e mbuluara:

i) çdo marrëveshje e arritur nëpërmjet procedurës së marrëveshjes së përbashkët/procedurës me mirëkuptim do të zbatohet pavarësisht nga çdo afat kohor në ligjet vendase të juridiksioneve kontraktuese; ose

ii) synon të përmbushë standardin minimal për përmirësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në kuadër të Paketës BEPS të OECD/G20, duke pranuar në negociatat dypalëshe të marr[veshjes, një dispozitë të marr[veshjes që përcakton se:

A) juridiksionet kontraktuese nuk do të bëjnë asnjë rregullim të fitimeve që i atribuohen një selie të përhershme të një ndërmarrjeje të një prej juridiksioneve kontraktuese pas një periudhe që është rënë dakord reciprokisht midis dy juridiksioneve kontraktuese nga fundi i vitit të tatueshëm në të cilin fitimet do t'i atribuoheshin selisë së përhershme (kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e mashtrimit, neglizhencës flagrante ose pakujdesisë së qëllimshme); dhe

B) juridiksionet kontraktuese nuk do të përfshijnë në fitimet e një ndërmarrjeje dhe as nuk do të tatojnë fitimet që do të ishin regjistruar nga një ndërmarrje, por që për shkak të kushteve të përmendura në një dispozitë në marrëveshjen për tatimet e mbuluara në lidhje me ndërmarrjet e lidhura nuk janë regjistruar pas një periudhe që është rënë dakord reciprokisht mes të dyja juridiksioneve kontraktuese nga fundi i vitit të tatueshëm në të cilin fitimet do të ishin regjistruar në ndërmarrje (kjo dispozitë nuk do të zbatohet në rastin e mashtrimit, neglizhencës flagrante ose pakujdesisë së qëllimshme).

6. a) Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 5, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në klauzolën “i”, të nënparagrafit “a”, të paragrafit 4, dhe nëse po, numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë do të zëvendësohet me fjalinë e parë të paragrafit 1. Në raste të tjera, fjalia e parë e paragrafit 1 do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në atë masë që ato dispozita nuk janë në përputhje me atë fjali.

b) Secila Palë që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 5, duhet të njoftojë Depozituesin, në lidhje me:

i. listën e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë që parashikon se një rast i përmendur në fjalinë e parë të paragrafit 1 duhet të paraqitet brenda një periudhe të caktuar kohore që është më e shkurtër se tre vjet nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, si dhe numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë; një dispozitë e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara do të zëvendësohet me fjalinë e dytë të paragrafit 1 kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me këtë dispozitë; në raste të tjera, në përputhje me klauzolën “ii”, fjalia e dytë e paragrafit 1 do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në atë masë që ato dispozita nuk janë në përputhje me fjalinë e dytë të paragrafit 1;

ii. listën e marrëveshjeve për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë që parashikon se

një rast i përmendur në fjalinë e parë të paragrafit 1 duhet të paraqitet brenda një periudhe të caktuar kohore që është të paktën tre vjet nga njoftimi i parë i veprimt që rezulton në tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, si dhe numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë; fjalia e dytë e paragrafit 1 nuk zbatohet në një marrëveshje për tatimet e mbuluara ku çdo juridiksion kontraktues ka bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë marrëveshje për tatimet e mbuluara.

c) Secila Palë do të njoftojë Depozituesin, për:

i. listën e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara të cilat nuk përmbajnë një dispozitë të përshkruar në klauzolën “i”, të nënparagrafit “b”, të paragrafit 4; fjalia e parë e paragrafit 2 do të zbatohet për një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë marrëveshje për tatimet e mbuluara;

ii. në rastin e një Pale që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “c”, të paragrafit 5, listën e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara të cilat nuk përmbajnë një dispozitë të përshkruar në klauzolën “ii”, të nënparagrafit “b”, të paragrafit 4; fjalia e dytë e paragrafit 2 do të zbatohet për një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë marrëveshje për tatimet e mbuluara.

d) Secila Palë do të njoftojë Depozituesin, për:

i. listën e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara të cilat nuk përmbajnë një dispozitë të përshkruar në klauzolën “i”, të nënparagrafit “c”, të paragrafit 4; fjalia e parë e paragrafit 3 do të zbatohet për një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm atëherë kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë marrëveshje për tatimet e mbuluara;

ii. listën e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara të cilat nuk përmbajnë një dispozitë të përshkruar në klauzolën “ii”, të nënparagrafit “c”, të paragrafit 4; fjalia e dytë e paragrafit 3 do të zbatohet për një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm atëherë kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë marrëveshje për tatimet e mbuluara.

## Neni 17

### **Rregullimet korresponduese**

1. Kur një juridiksion kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij juridiksioni kontraktues - dhe taton në përputhje me rrethanat – fitimet për të cilat një ndërmarrje e juridiksionit tjetër kontraktues i është nënshtruar tatimit në atë juridiksion tjetër kontraktues dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin grumbulluar në ndërmarrjen e juridiksionit të parë kontraktues të lartpërmendur, nëse kushtet e vendosura ndërmjet dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë juridiksioni tjetër kontraktues do të bëjë një rregullim të duhur në shumën e tatimit të vendosur për ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'i kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të marrëveshjes për tatimet e mbuluara dhe autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese do të konsultohen me njëra-tjetrën nëse është e nevojshme.

2. Paragrafi 1 do të zbatohet në vend të ose në mungesë të një dispozite që kërkon që një juridiksion kontraktues të bëjë një rregullim të duhur në shumën e tatimit të vendosur për fitimet e një ndërmarrjeje të atij juridiksioni kontraktues kur juridiksioni tjetër kontraktues përfshin këto fitime në fitimet e një sipërmarrjeje të atij juridiksioni tjetër kontraktues dhe i taton ato fitime në përputhje me rrethanat, dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitimet që do të ishin grumbulluar në ndërmarrjen e atij juridiksioni tjetër kontraktues, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura.

3. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 2;

b) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara mbi bazën se në mungesë të një dispozite të referuar në paragrafin 2 në marrëveshjet e saj për tatimet e

mbuluara:

i. Pala do të bëjë rregullimin e duhur të referuar në paragrafin 1; ose  
ii. autoriteti i saj kompetent do të përpiqet të zgjidhë çështjen sipas dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara në lidhje me procedurën e marrëveshjes së ndërsjellë (zgjidhjes me mirëkuptim);

c) në rastin e një Pale që ka bërë një rezervë sipas klauzolës “ii”, të nënparagrafit “c”, të paragrafit 5, të nenit 16 (“Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë-procedura me mirëkuptim”), të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara mbi bazën e faktit që, në kuadër të negociatave të marrëveshjeve dypalëshe të saj, do të pranojë një dispozitë të marrëveshjes së tipit të përmendur në paragrafin 1, me kusht që juridiksionet kontraktuese të mund të arrijnë marrëveshje mbi këtë dispozitë dhe mbi dispozitat e përshkruara në klauzolën ii) të nënparagrafit “c”, të paragrafit 5, të nenit 16 (“Procedura e marrëveshjes së përbashkët – procedura me mirëkuptim”).

4. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në paragrafin 3 do të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 2 dhe nëse po, numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Atëherë kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë zëvendësohet me dispozitat e paragrafit 1. Në raste të tjera, paragrafi 1 do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në masën që këto dispozita nuk janë në përputhje me paragrafin 1.

## PJESA VI ARBITRAZHI

Neni 18

### **Opsioni për të zbatuar pjesën VI**

Një Palë mund të zgjedhë ta zbatojë këtë pjesë në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e Mbuluara dhe do të njoftojë Depozituesin në përputhje me rrethanat. Kjo pjesë do të zbatohet në lidhje me dy juridiksione kontraktuese në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të dy juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë.

Neni 19

### **Arbitrazhi i detyrueshëm**

1. Atëherë, ku:

a) sipas një dispozite të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga paragrafi 1, i nenit 16 (“Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë – procedura me mirëkuptim”) që parashikon se një person mund të paraqesë një çështje te një autoritet kompetent i një juridiksioni kontraktues kur ai person konsideron se veprimet e një ose të dyja juridiksioneve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për atë person në tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga Konventa), personi ka paraqitur një rast pranë autoritetit kompetent të një juridiksioni kontraktues në bazë të faktit që veprimet e njëres apo të dy juridiksioneve kontraktuese kanë rezultuar për atë person në tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga konventa); dhe

b) autoritetet kompetente nuk mund të arrijnë një marrëveshje për të zgjidhur këtë çështje në përputhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga paragrafi 2 i nenit 16 (“Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë – procedura me mirëkuptim”) që parashikon se autoriteti kompetent do të përpiqet të zgjidhë çështjen me marrëveshje të ndërsjellë/me mirëkuptim me autoritetin kompetent të juridiksionit tjetër kontraktues, brenda një

periudhe dyvjeçare që fillon në datën e referuar në paragrafin 8 ose 9, sipas rastit (me përjashtim të rastit kur, para mbarimit të asaj periudhe autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese kanë rënë dakord për një periudhë të ndryshme kohore në lidhje me atë rast dhe kanë njoftuar personin që ka paraqitur çështjen për një marrëveshje të tillë),

çdo çështje e pazgjidhur që rezulton nga ky rast, nëse personi e kërkon me shkrim, do të paraqitet në arbitrazh në mënyrën e përshkruar në këtë pjesë, sipas çdo rregulle ose procedure të rënë dakord nga autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese në përputhje me dispozitat e paragrafit 10.

2. Kur një autoritet kompetent ka pezulluar procedurën e marrëveshjes së ndërsjellë/me mirëkuptim, të referuar në paragrafin 1, sepse një çështje në lidhje me një ose më shumë çështje të njëjta është në pritje përpara gjykatës ose gjykatës administrative, periudha e parashikuar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 1, do të ndërpritet deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata ose gjykata administrative ose deri në pezullimin ose tërheqjen e çështjes. Përveç kësaj, kur një person i cili ka paraqitur një rast dhe një autoritet kompetent kanë rënë dakord të pezullojnë procedurën e marrëveshjes së përbashkët, periudha e parashikuar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 1, do të ndërpritet derisa të hiqet pezullimi.

3. Kur të dy autoritetet kompetente bien dakord që një person i prekur drejtpërdrejt nga çështja nuk ka dhënë në kohën e duhur çdo informacion material shtesë të kërkuar nga autoriteti kompetent pas fillimit të periudhës së parashikuar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 1, periudha e parashikuar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 1, do të zgjatet për një kohë të barabartë me periudhën që fillon në datën në të cilën është kërkuar informacioni dhe përfundon në datën në të cilën është dhënë informacioni.

